
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 06.03.2026

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje automjeti elektrik për punimet në terren në kuadër të projektit EMOD- net, për SHGJSH”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

34100000-8 Automjete
34144900-7 Automjete elektrike

Vlera e fondit limit: 3,387,300 (tre milion e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind) **lekë pa TVSH**, (TVSH është e pa aplikueshme sipas parashikimeve të nenit 51 germa “p” e ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e autoveturës objekt prokurimi, gjatë periudhës së garancisë, në servisën e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjetit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qenë se mjeti është kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për

përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

7. Operatori ekonomik ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mjetin e ofruar, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 3 (tre) vite ose minimumi 100.000 km, në varësi se cili kusht do të plotësohet i pari.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

8. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar dhe regjistruar në pronësi të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare, siguracion TPL).

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorezohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të dhëna të përgjithshme:

- **Modeli:** Makinë Elektrike 0 emission
- **Viti i prodhimit:** 2025
- **Klasa e automjetit:** SUV i mesëm (Mid-size SUV)
- **Lloji i energjisë:** 100% Elektrik
- **Sistemi i lëvizjes:** AWD (4x4) – dy motorë elektrikë

Performanca:

- **Fuqia maksimale:** > 380 kW ($\approx$ 530 HP)
- **Çifti rrotullues (Torque):** > 680 Nm
- **Shpejtësia maksimale:** > 220 km/h

Bateria dhe autonomia:

- **Lloji i baterisë:** Lithium Iron Phosphate (LFP)
- **Kapaciteti i baterisë:** > 80 kWh
- **Autonomia (WLTP):** > 500 km

Përmasa dhe karakteristikat e makinës:

- **Gjatësia:** > 4800 mm
- **Gjerësia:** > 1920 mm
- **Lartësia:** > 1600 mm
- **Pesha:** > 2200 kg
- **Numri i dyerve:** 5
- **Numri i vendeve:** 5
- **Disqe frenash:** të ventiluara
- **Përmasa e gomave:** 235/50 R19 ose 245/45 R20

Pajisjet e brendshme (Interior):

- Timon lëkure multifunksional
- Sedilje lëkure
- Sedilje të përparme me rregullim elektrik
- Sedilje të përparme me ngrohje dhe ventilim
- Memorie pozicioni për sediljet e përparme
- Sedilje të pasme me ngrohje
- Mbajtëse gotash për sediljet e pasme

Multimedia:

- Ekran qëndror me prekje (Touch LCD)
- Madhësia e ekranit qëndror: > **15.0 inch**
- Bluetooth / Telefon në makinë
- Sistem audio i avancuar, i integruar nga fabrika, me cilësi të lartë tingulli
- Më shumë se **10 altoparlantë**
- USB, Type-C dhe SD Card
- Aplikacion mobil për menaxhim në distancë (APP)
- Menaxhim karikimi dhe kontroll klimatik në distancë

Siguria:

- Airbag frontalë dhe anësorë
- Airbag perde për mbrojtjen e kokës
- Sistem monitorimi i presionit të gomave (TPMS)
- ISOFIX për sedilje fëmijësh
- ABS – sistem kundër bllokimit të frenave
- Shpërndarje elektronike e forcës së frenimit
- Asistencë elektronike në frenim
- Kontroll tërheqjeje (Traction Control)
- Monitorim i këndit të verbër
- Paralajmërim për largim nga korsia
- Frenim emergjent autonom
- Sistem detektimi të lodhjes së shoferit
- Mbyllje qendrore

Teknologji & Asistencë në drejtim:

- Lane Keeping Assist
- Njohje e sinjalistikës rrugore
- Cruise Control adaptiv (Full Speed)
- Sistem i avancuar sensorësh për drejtim të asistuar (ADAS), i përbërë nga kombinim sensorësh perceptimi si kamera, radarë ose teknologji ekuivalente.
- Automjeti duhet të jetë i pajisur me të paktën një (1) sensor LiDAR funksional, i integruar nga fabrika, për përdorim në sistemet e asistencës në drejtim (ADAS)."
- Radar parkimi
- Sistem parkimi me kamera
- Pamje panoramike 360°
- Auto Hold
- Asistencë në ngjitje (Hill Assist)
- Parkim automatik

- Pezullim me funksion variabël
- Keyless Entry & Start
- Karikues wireless për telefon

Ndriçimi:

- Fenerë LED
- Fenerë automatikë
- Drita ditore LED (DRL)
- Rregullim automatik i lartësisë së fenerëve
- Modalitet shiu/mjegulle
- Drita adaptive (High Beam)
- Ndriçim ambiental me **25-30 ngjyra**

Xhama & Pasqyra:

- Pasqyra anësore me rregullim elektrik dhe ngrohje
- Palosje automatike e pasqyrave
- Memorie pozicioni për pasqyrat
- Tavan panoramik
- Xhama elektrike përpara dhe pas
- Funksion one-touch dhe anti-pinch
- Fshirëse automatike me sensor shiu

Klimatizimi:

- Klimë automatike me dy zona
- Kondicioner i pavarur për pasagjerët e pasmë
- Gryka ajri për sediljet e pasme
- Filtrim ajri PM 2.5 ose ekuivalente
- Gjenerator jonizimi ose teknologji ekuivalente

Pajisje shoqëruese të automjetit elektrik:

- Karikues të tipit Wall – Box ≥ 7 kWh, copë 2 (dy)
- Karikues portativ, copë 1 (një)

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Projekti EMODnet kërkon lëvizje të vazhdueshme në zonat bregdetare të Shqipërisë për kryerjen e studimeve gjeologjike, matjeve batimetrike dhe monitorimit mjedisor. Blerja e një automjeti elektrik përmbush njëkohësisht nevojat operative dhe detyrimet ligjore për efijencën energjetike. Gjithashtu blerja e një automjeti elektrik ul kostot duke kursyer blerjen e karburantit.

Kuadri ligjor për efijencën e energjisë

Blerja e automjetit elektrik mbështetet në kuadrin e plotë ligjor shqiptar për efijencën e energjisë:

Ligji Nr. 124/2015 “Për Efijencën e Energjisë” (i ndryshuar) - Neni 5, pika 1, gërma “ç” përcakton se institucionet publike duhet të promovojnë përdorimin e automjeteve me efijencë të lartë energjetike. Neni 15 detyron sektorin publik të zbatojë masa për reduktimin e konsumit të energjisë në transport.

VKM Nr. 709, datë 1.12.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efijencën e Energjisë 2022-2024” - Seksioni 4.3 parashikon masa specifike për sektorin e transportit, duke përfshirë zëvendësimin e flotës së automjeteve publike me automjete elektrike ose hibride.

VKM Nr. 432, datë 22.6.2022 “Për kriteret e prokurimit të gjelbër” – Përcakton kriteret mjedisore për blerjet publike, duke favorizuar automjetet me emetim zero ose të ulët të CO₂.

Ligji Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” - Neni 7 parashikon reduktimin e emetimeve të gazeve serrë nga sektori i transportit dhe nxit përdorimin e automjeteve me emetim zero.

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030 - Objektivi 3.4 synon rritjen e përdorimit të automjeteve elektrike në sektorin publik me 30% deri në vitin 2030.

Direktivat e **BE-së** - Në kuadër të procesit të integritit evropian, Shqipëria ka përafruar legjislacionin me Direktivën 2012/27/EU për efikasencën e energjisë dhe Direktivën 2019/1161/EU për automjetet e pastra.

Përfitimet e blerjes

- Përmbyshja e detyrimeve ligjore për efikasencën energjetike të sektorit publik;
- Reduktim i kostove operative (karburant, mirëmbajtje) me rreth 60-70%;
- Zero emetim gazrash serrë gjatë operimit;
- Përputhshmëri me kriteret e prokurimit të gjelbër të BE-së;
- Imazh pozitiv institucional në kuadër të projekteve ndërkombëtare;
- Autonomia 500 km siguron mbulim të plotë për punimet në terren pa ndërprerje. Financimi do të sigurohet nga fondet e projektit EMODnet Gjeologji loti 1, për vitin 2026.

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfituese, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT